



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 501/5 Prot

Datë 28/2 2022

VENDIM

Nr 7, Datë 21.02.2022

PËR
“MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE SHITESË TË STUDENTËVE PËRFITUES
BURSE,REDUKTIM / PËRJASHTIM TARIFE, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 903, datë 21.12.2016 Të këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fodi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer , studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar”, me VKM nr. 784 , datë 26.12.2018; VKM nr 39, datë 23.01.2019, VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar me VKM-në nr. 698, datë 21.11.2018, nr. 779, datë 26.12.2018; VKM nr. 40, datë 23.01.2019; VKM nr. 251, datë 27.03.2020;VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”; VKM nr. 778, datë 26.12.2018 “ për një ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, të këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve , në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë “, të ndryshuar; materialit të paraqitur nga Administratori i UT-së Bordi i Administrimit,

Vendosi:

1. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas formularit nr.1,1/1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të dytë me kohë të plotë që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas formularit nr.2, 2/1 bashkëlidhur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

3. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë përjashtim në masën 50 % të tarifës sipas formularit nr.3 bashkëlidhur.
4. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë bursë sipas formularit nr.4,4/1 bashkëlidhur.
5. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në buxhetin e vitit 2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij për vitin akademik 2021-2022.
7. Ky vendim t'i njoftohet AKFAL-it, MASR-së, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit të Tiranës për vitin 2022, sipas pasqyrës nr.5 bashkëlidhur.

KRYETARE
ADELA KARAPICI